

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

InfoSoft Office

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

J62426002Q

NUIS/NIPT

Koder Kashar, Autostrada Tirane-Durres, Km 8

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0692036179

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

aarapi@infosoftoffice.al

E-mail

Administrator Frederik Prodani

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2023/09/19

Data (viti/muaji/dita)

+355696407424

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.

REF-79712-09-12-2023

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

Autoriteti/Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tirane

Vlera e përlogaritur e prokurimit

Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)

7871000

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.

Blerje mjete didaktike

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

Data (viti/muaji/dita)

2023/09/25

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/09/25

Numri i njoftimit

Kodi CPV

787100

37000000-837413220-437520000-937523000-

Ankese mbi argument në KPP

Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligjin për Prokurimin Publik, nr. 162 dt. 23.12.2020, në mbështetje të nenëve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave.

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet □

Përshkruani rrethanat e faktit. □

3. Rrethanat dhe faktet

Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tirane, ka publikuar në faqen e APP-se në datë 13.09.2023, tenderin me objekt “Blerje mjete didaktike”, i cili parashikohet të zhvillohet me datë 25.09.2023, ora 0900.

Duke qenë se disa prej këtyre kërkesave i gjykojmë në shkelje të LPP, Rregullave të Prokurimit Publik, po paraqesim këtë ankesë.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.

1. Në kriteret e vecanta në DST, në pikën 2.3.4, AK ka kërkuar:

2.3.4 OE duhet të paraqesë katalog ose pjesë të katalogut ku të tregohen qartazi lloji i artikullit (lodres) permasat dhe të dhënat e prodhuesit.

Kjo kërkesë mund të perceptohet si e ekzagjeruar dhe e tepert duke pasur parasysh praninë e kërkesave të tjera nga AK, si Deklarata e Konformitetit (CE) dhe paraqitja e mostrave fizike në ditën e hapjes së ofertave.

Deklarata e Konformitetit është një dokument ligjor i detyrueshem që deshmon përputhshmërinë e produkteve me standardet dhe specifikimet përkatëse. Brenda kësaj deklarate, pritet që OE të identifikojë qartë artikujt për të cilët është leshuar deklarata dhe të krijojë një lidhje të qartë midis produkteve me deklaratën e konformitetit. Prandaj, kerkimi i një katalogu me informacion të ngjashëm dyfishon përpjekjet dhe shton një barre të panevojshme për operatorët ekonomik, pasi detajet kryesore do të jenë tashme të pranishme në deklaratën e konformitetit.

Për më tepër, paraqitja e mostrave fizike në ditën e hapjes së ofertave është një masë thelbësore për të garantuar plotësimin e specifikimeve teknike të artikujve të kërkuar. Këto mostra u ofrojnë zyrtarëve të prokurimit një mundësi të prekshme për të inspektuar produktet dhe për të verifikuar nëse ato përputhen me kërkesat e përshkruara në kërkesën e prokurimit. Në këtë kuptim, mostrat fizike ofrojnë një demonstrim të përputhshmërisë në botën reale, duke e bërë rolin e katalogut më pak të rëndësishëm.

Si përfundim, është e diskutueshme që kërkesa e pikës 2.3.4 për një katalog, duke pasur parasysh praninë e deklaratës së konformitetit dhe ofrimin e mostrave fizike, mund të shihet si kërkesë e ekzagjeruar. Heqja e kësaj kërkesë mund të thjeshtojë procesin e prokurimit, të zvogëlojë barrën administrative si për autoritetet kontraktore ashtu edhe për OE, dhe do të ruajë ende sigurimin e fortë të cilësisë përmes deklaratës së konformitetit dhe mostrave fizike.

Duke rivlerësuar dhe duke hequr këtë kërkesë, Autoriteti Kontraktor mund të nxisë efikasitet me të madh dhe të inkurajojë pjesëmarrje me të gjera në procesin e prokurimit.

1. Ne kriteret e vecanta ne DST, ne piken 2.3.6 AK ka kerkuar:

2.3.6 Diten e hapjes se tenderit, Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje moster te realizuar sipas specifikimeve teknike te Autoritetit Kontraktor dhe sipas deklarates se konformitetit te depozituar ne SPE sipas kriterit 2.3.3.

Gjykojme se kriteri i mesiperm nuk eshte ne proporcion me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet. Nga sa me siper ne lidhje me kete kriter theksojme faktin se Autoriteti Juaj kontraktor nuk mund te kerkoje qe operatoret ekonomik te interesuar per te marre pjese ne kete procedure prokurimi, te paraqesin ne daten dhe oren e caktuar mostra per artikujt te cilat kerkohen ne sasi te vogla ne propocion me permasat e kontrates. Ne baze te ligjit te prokurimeve ne fuqi autoriteti kontraktor per te garantuar mallra/produkte konforme standardeve qe percaktojne kane te drejte te kerkojne qe produktet e caktuara te sillen si mostra, por ne asnje rast nuk jep te drejten e autoriteteve kontraktore te kerkojne mostra per produkte te cilat edhe ne sasi, ne kuptimin e levrimin te mallrave ne perfundim te procedures se prokurimit, jane ne sasi te vogla, krahasuar me artikujt te tjere ku sasia e tyre eshte e madhe.

Veme re se AK ka kerkuar mostra edhe per artikuj me sasi te vogla objekt prokurimi, Kjo kerkese eshte e ekzagjeruar dhe ne tejkalim te ligjit.

Lidhur me paraqitjen e mostrave edhe per artikuj me perdorueshmeri te ulet, KPP eshte shprehur menyre te vazhdueshme, konkretisht ne vendimin K.P.P. 122/2020:

“? Komisioni gjykon se, eshte e mjaftueshme qe operatoret ekonomike pjesemarres te paraqesin vetem nga nje ekzemplar (moster) per produktet qe do te prokurohen, me perdorueshmeri me te larte per institucionin, me qellim verifikimin nese keto produkte plotesojne kerkesat dhe specifikimet teknike te percaktuara ne dokumentat e tenderit.”

Ne keto kushte kerkojme modifikimin e ketij kriteri, ne menyre qe kerkesat te jene ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates, te kerkohen mostra vetem per artikujt me perdorim me te madh me sasi mbi 250 artikuj. Duke kerkuar mostra edhe per ato artikuj qe AK do ti bleje ne nje sasi fare te vogel, ngarkohen OE me shpenzime ekonomike te panevojshme, pasi detyrohen te blejne mostrat, qe ne momentin e ofertimit

2. Ne kriteret e vecanta ne DST, gjithashtu ne piken 2.3.6 AK ka kerkuar:

2.3.6 Diten e hapjes se tenderit, Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje moster te realizuar sipas specifikimeve teknike te Autoritetit Kontraktor dhe sipas deklarates se konformitetit te depozituar ne SPE sipas kriterit 2.3.3.

Mostrat do te paraqiten ne daten dhe oren e hapjes se ofertave prane D.P.Ç.K., Rruga e Barrikadave, Çerdhje nr. 1, Tirane.

Ne secilen loder duhet te jete qartazi i dukshem markimi “CE”.

Markimi CE vendoset ne loder ne nje etikete te fiksuar ne loder ose ne paketimin e saj ne menyre te dukshme, te lexueshme dhe te paheqshme.

Cdo artikull duhet te jete i ambalazhuar ne ambalazh te personalizuar, ne te cilet duhet te duken qartazi emri dhe adresa e prodhuesit.

Ne amblazhin e secilit artikull duhet te jete etikimi ne gjuhen shqipe per:

Emertimin e mjetit didaktik/ lodres

Pershkrimi i shkurter i menyres se perdorimit.

Materiali perberes i artikullit (lodres).

Mosha e keshilluar per perdorim.

Vendi i origjines

Etiketat e vendosura dhe instruksionet e perdorimit qe shoqerojne artikujt duhet te terheqin vemendjen e perdorueseve ose mbikeqyresve te tyre mbi rreziqet dhe risqet e mundshme te

demtimit qe perfshihen gjate perdorimit te lodrave si dhe menytrat mbi shmangiet e rreziqueve dhe risqeve te tilla.

Mostrat e kerkuara duhet te kene nje etikete te ngjitur, e cila te permbaje te dhenat: Moster “emri i artikullit”, daten e zhvillimit te tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nenshkrimin dhe vulen e Operatorit Ekonomik. Etiketa e ngjitur nuk duhet te mbuloje te dhenat e kerkuara me siper.

Mos paraqitja mostrave te kerkuara ne vendin, ditën dhe oren e hapjes se ofertave per te gjithë mallrat objekt prokurimi eshte kusht per skualifikim.

Ne propozojme heqjen e dy kerkesave specifike ne lidhje me etiketimin e mostres, domethene, shenimin e emrit te ofetuesit/ prodhuesit dhe dates se tenderit. Keto kerkesa, megjithese me qellime te mira, imponojne nje barre te konsiderueshme per Operatoret Ekonomike.

Nje nga arsyet kryesore per heqjen e ketyre kerkesave eshte sasia e konsiderueshme e kohes qe ato harxhojne. OE tashme jane te angazhuar ne procese komplekse per ofrimin e mostrave dhe shtimi i detyres se etiketimit me informacion te detajuar vetem shton ngarkesen e tyre te punes. Heqja e ketyre kerkesave do te thjeshtonte pergjegjesite e tyre, duke i lejuar ata te ndajne kohën dhe burimet e tyre ne menyre me efektive.

Shenimi i emrit te tenderuesit dhe dates se tenderit ne etiketat e mostrave kopjon informacionin qe eshte lehtesisht i disponueshem per Autoritetin Kontraktues. AK-ja ka qasje ne te gjitha detajet perkatese rreth procesit te tenderit, duke perfshire daten e zhvillimit te tenderit dhe emrat e OE-ve pjesemarres. Kerkimi i OE-ve per te dyfishuar kete informacion nuk sherben per asnje qellim praktik dhe shton hapa te panevojshem administrative ne proces. Thjeshtimi i procesit te etiketimit te mostres duke hequr keto kerkesa do ta lehtesonte kete barre, duke e bere te gjithë procesin e prokurimit me efikas.

Si perfundim, heqja e kerkesave per te shenuar emrin e ofertuesit dhe daten e tenderit ne etiketat e mostrave eshte nje hap logjik drejt thjeshtimit te procesit te prokurimit. Ai lehteson barren e OE-ve, eliminon tepricat dhe perputhet me praktikaten me te mira per prokurim efikas. Ne fund te fundit, ky ndryshim do te rriste efikasitetin dhe efektivitetin e pergjithshem te procesit te tenderimit.

Gjithashtu po ne kete pike nga AK kerkohet qe: “Cdo artikull duhet te jete i ambalazhuar ne ambalazh te personalizuar, ne te cilet duhet te duken qartazi emri dhe adresa e prodhuesit.” Ne procesverbalin e argumentimit nuk eshte bere e qarte se per cfare arsye do te jete e nevojshme kjo kerkesa. Shqetësimi kryesor duhet të jenë specifikimet, standardet e sigurisë dhe cilësia e tyre, dhe jo identiteti i prodhuesit. Vënia e theksit të panevojshëm në detajet e prodhuesit i ul atributet aktuale të produktit. Konsumatorët janë më të interesuar për atë që po blejnë, si përbërësit, veçoritë e sigurisë dhe udhëzimet e përdorimit, sesa për identitetin e prodhuesit. Do te mjaftonte te shenohej numri rendor i produktit sipas tabelës se specifikime teknike ne menyre qe nga ana juaj te jete lehtesisht i identifikueshme artikulli.

Neni 2 i ligjit 162/2021 “Per Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

Qellim i ketij ligji eshte: a) te rrise eficencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik; b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale; c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; ç) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithë operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik; dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik.

Neni 3 Parime te pergjithshme

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per operatoret ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne 5 menyre proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore jane te detyruara te zbatojne detyrimet e percaktuara ne legjislacionin mjedisor, social e te punes dhe ne dispozitat e marreveshjeve dhe konventat nderkombetare, te ratifikuara ne perputhje me Kushtetuten. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor eshte pergjegjes per prokurimin ne perputhje me dispozitat e ketij ligji dhe te akteve nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij, duke garantuar respektimin e parimeve te trajtimit te barabarte, transparences, konkurrences dhe mosdiskriminimit, te parashikuara ne kete ligj. Ne kuptim te kesaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin te mireplanifikoje ne cilesi dhe ne kohe fondet publike e nevojat e tij dhe te prokuroje e te zbatoje kontraten ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Ne nenin 36 te ligjit nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik" parashikohet shprehimisht se: "Specifikimet teknike, siç percaktohen ne nenin 4 te ketij ligji, duhet te pershkruhen ne dokumentet e tenderit. Ne specifikimet teknike percaktohen qarte karakteristikat e puneve, sherbimit ose furnizimit qe do te prokurohet. Keto karakteristika mund te lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit te puneve, furnizimeve ose sherbimeve te kerkuara ose me nje proces specifik per nje faze tjeter te ciklit jetesor edhe kur keta faktore nuk perbejne permbajtjen e saj thelbore nese ato jane te lidhura me objektin e kontrates dhe proporcionale me vleren dhe objektivat e saj. Ne specifikimet teknike mund te specifikohet edhe nese do te jete i nevojshem transferimi i te drejtave te pronesisë intelektuale. Specifikimet teknike, me perjashtim te rasteve te justifikuara plotesisht, hartohen ne menyre te tille qe te marrin ne konsiderate kriteret e aksesueshmerise per personat me aftesi te kufizuar ose projektimit per te gjithë perdoruesit, sipas kerkesave ne legjislacionin ne fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet te mundesojne trajtim te barabarte per te gjithë kandidatet dhe ofertuesit dhe te mos sherbejne si pengesa per konkurrencen e hapur ne prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet te pershkruajne qarte kerkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kerkesave funksionale ose te performances, perfshire karakteristikat mjedisore, me kusht qe parametrat te jene te sakte ne menyre qe t'u japin mundesi ofertuesve te percaktojne objektin e kontrates dhe autoriteteve ose enteve kontraktore te japin kontraten; b) standardeve kombetare, qe mbeshteten ne ato nderkombetare, miratimeve teknike nderkombetare, specifikimeve teknike te pergjithshme, standardeve nderkombetare apo sistemeve te tjera teknike te referimit, te percaktuara nga organet nderkombetare te standardizimit. Kur keto nuk ekzistojne, ato u referohen standardeve kombetare, miratimeve teknike kombetare ose specifikimeve teknike kombetare, qe lidhen me projektimin, perlllogaritjen dhe ekzekutimin e puneve ose perdorimin e produkteve; 6 c) kerkesave ne terma funksionale sipas shkronjes "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjes "b" te kesaj pike, si menyre qe nenkupton pajtueshmeri me kerkesat funksionale; ç) te dyja metodave te percaktuara ne shkronjat "a" dhe "b" te pikes 3 te ketij neni, per mallra, sherbime ose pune te ndryshme, te perfshira ne te njejtin objekt kontrate. Çdo reference duhet te shoqerohet nga fjalet "ose ekuivalenti i tij/saj". 4. Ne specifikimet teknike, nese nuk e justifikon objekti i kontrates, nuk duhet te permendet asnje marke prodhimi ose burim specifik apo proces i veçante, qe karakterizon produktet ose sherbimet e ofruara nga nje operator ekonomik specifik apo asnje marke tregtare, patente, tipi ose origjine apo prodhim specifik, me qellim favorizimin ose eliminimin e disa sipermarreve ose produkteve. Nje gje e tille lejohet vetem ne raste perjashtimore kur nuk ekziston nje menyre e mjaftueshme, e sakte apo e kuptueshme e pershkriminimit te objektit te kontrates, sipas pikes 3 te ketij neni. Referime te tilla duhet te shoqerohen nga fjalet "ose ekuivalente". 5. Ne rast se autoriteti ose enti kontraktor percakton specifikimet teknike ne baze te shkronjes "b" te pikes 3 te ketij neni, nuk mund te refuzoje nje oferte me argumentin se punet, furnizimet apo sherbimet per te cilat eshte dorezuar oferta nuk

plotesojne specifikimet teknike, te cilave u referohen, per sa kohe qe ofertuesi provon ne oferten e tij me ?do mjet te pershtatshem qe zgjidhjet e propozuara permbushin kerkesat e percaktuara ne specifikimet teknike ne menyre ekuivalente. 6. Ne rast se autoriteti ose enti kontraktor percakton specifikimet teknike ne baze te shkronjes "a" te pikes 3 te ketij neni, ai nuk mund te refuzoje nje oferte per pune, mallra apo sherbime, e cila eshte ne perputhje me standardet kombetare, qe mbeshteten ne ato nderkombetare, miratimet teknike nderkombetare, specifikimet teknike te pergjithshme, standardet nderkombetare apo sistemet e tjera teknike te referimit, te percaktuara nga organet nderkombetare te standardizimit kur keto specifikime teknike permbushin kriteret funksionale, te percaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

nuk ka

7. Lista e informacionit konfidencial:

nuk ka

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes: Ankimesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail:

aarapi@infosoftoffice.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit

Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar

Frederik Prodani